



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTVENDIM

PËR PROCEDURËN PARAPRAKE TË PËRZGJEDHJES SË TRE ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 44 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet procedura paraprake e përzgjedhjes së tre anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës së Bankës së Shqipërisë, sipas fazave të mëposhtme:

a) Shërbimet e Kuvendit të shpallin dhe të bëjnë publike vakancën e organit kushtetues nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik). Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë CV-në e kandidatit për përmbushjen e kriterëve ligjore, si dhe pëlqimi i kandidatit me shkrim. Afati i dorëzimit të dokumentacionit të bëhet brenda 15 ditëve nga publikimi.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 10 ditëve nga dërgimi i njoftimit të deputetët i listës së kandidaturave të vetofruar, organizojnë dëgjesën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit, njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare për ditën, orën dhe mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjesës publike, të paktën 28 deputetë, përzgjedhin kandidatin/kandidatët, të cilët do të mbështesin për t’ia paraqitur Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

II. Procedura paraprake e propozuar në pikën I, të këtij vendimi, nuk është e detyrueshme për t'u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast, që të paktën 28 deputetë t'i paraqesin Kuvendit një kandidat që është përzgjedhur prej tyre jashtë porcedurës së sipërcituar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën _____